




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.68/2024

Datë: 7 mars 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, sipas raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/06/2022/GJA-ADGJA.nr.02/2022, të datës 16 shkurt 2024, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 7 mars 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, pika 1.2 dhe 1.3, lidhur me paragrafin 2, pika 2.5, 2.8 dhe 2.15, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, (më tutje Këshilli) ka pranuar nga autoriteti kompetent kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor me pretendim se Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, mund të ketë kryer shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, pika 1.2 dhe 1.3, lidhur me paragrafin 2, pika 2.5, 2.8 dhe 2.15, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor autoriteti kompetent e ka mbështetur në ankesën e paraqitur nga _____ nga Prishtina ndaj gjyqtarit Ylber Shurdhiqi, lidhur me lëndën C.nr.5912/21, me pretendim se gjyqtari në fjalë është i korruptuar. Duke u bazuar në dispozitën e nenit 12, paragrafi 2 dhe 4 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe nenit 7 dhe 8 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, autoriteti kompetent ka kërkuar nga Këshilli që të filloj hetimin disiplinor ndaj gjyqtari Ylber Shurdhiqi.

Këshilli me vendimin KGJK.nr.115/2022, të datës 10 mars 2022, ka themeluar panelin hetimor për këtë rast disiplinor të evidentuar AD.KGJK/06/2022/GJA-ADGJA.nr.02/2022, ndërsa në të njëjtën mbledhje me vendimin KGJK.nr.114/2022, gjyqtarin Ylber Shurdhiqi e ka suspenduar nga

detyra e gjyqtarit në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil në Gjykatën e Apelit, deri në një vendim tjetër. Me këtë rast, Këshilli ka vlerësuar se suspendimi i gjyqtarit në këtë fazë të procedurës do të krijoj parakushte që paneli hetimor ta hetoj në tërësi çështjen në mënyrë objektive, duke e pamundësuar çfarëdo ndikimi në procedurën disiplinore. Suspendimi i gjyqtarit nuk ka prejudikuar mënyrën e zhvillimit të procedurës dhe as përfundimin e procedurës, por e ka lehtësuar procesin e hetimit disiplinor.

Duke pasur parasysh se ankesa e _____ ndaj gjyqtari Shurdhqi ka pasur të bëjë me dyshimet për kryerje të veprës penale të korrupsionit, Këshilli bazuar në nenin 11, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i ka dërguar këtë lëndë disiplinore të evidentuar ADGJA.nr.02/2022 ish Kryeprokurorit të Prokurorisë së Shtetit _____ duke i kërkuar që sipas të njëjtit nen, paragrafi 4, të njoftohet autoriteti kompetent lidhur me rezultatin e procedurës penale.

Në këtë drejtim paneli hetimor me vendimin e datës 06.05.2022, e ka suspenduar procedurën disiplinore për rastin Nr.AD/KGJK/06/2022/GJA-ADGJA.nr.02/2022, ndaj Ylber Shurdhqi deri sa të njoftohet lidhur me procedurën penale nga Prokuroria Speciale në Prishtinë.

Këshilli, pas pranimit të raportit PPN.nr.69/2022, për mbyllje të rastit, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës-Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar, në mbledhjen e mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, e shqyrtoj të njëjtin dhe vendosi që ta revokoj vendimin e evidentuar KGJK.nr.114/2022, të datës 10 mars 2022, për suspendimin e gjyqtarit Ylber Shurdhqi. Duke marrë parasysh që suspendimi ishte caktuar nga shkaku që gjyqtari në veprimet e tija mund të ketë konsumuar elemente të veprës penale, prandaj më këtë rast, pas konfirmimit që gjyqtari nuk është përfshirë në vepër penale, suspendimi i të njëjtit vlerësohet se nuk është i nevojshëm. Sipas vlerësimit të Këshillit, paneli hetimor në përputhje me nenin 9, të Ligjit Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duhet të vazhdoj hetimin disiplinor në qoftë se rasti përmban elemente të shkeljes disiplinore dhe ti dorëzoj Këshillit raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura.

Me datë 16 shkurt 2024, paneli hetimor i ka paraqitur Këshillit raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar, ndërsa Këshilli me datë 7 mars 2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore, në të cilën kanë prezantuar kryesuesi i paneli hetimor gjyqtari Alush Sinani dhe subjekti i hetimit se bashku me avokatin e tij Naser Peci.

Kryesuesi i panelit hetimor, në seancën dëgjimore të mbajtur në Këshill, deklaroi se bazuar në Ligjin 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën ka prezantuar subjekti i hetimit disiplinor dhe avokati i tij Naser Peci. Gjatë kësaj seance dëgjimore, subjekti i hetimit disiplinor nuk ka pranuar shkeljen disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent. Me tutje, subjekti i hetimit kishte theksuar se pretendimet e ankuesit _____ se ai ka komunikuar me palët në lidhje me lëndën të cilën e ka pasur në shqyrtim nuk qëndrojnë, janë të pa vërteta dhe se ekzistojnë mekanizma institucional të cilët verifikojnë vërtetësinë e këtyre komunikimeve. Për këtë lëndë, që ka qenë kontest nga marrëdhënia e punës, ka pasur edhe kërkesë për caktimin e masës së sigurisë dhe në lidhje me këtë çështje subjekti i hetimit ka marrë një vendim, kundër të cilit është ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë, dhe sipas njohurive të tij lëndë ka shkuar edhe në Gjykatën Supreme.

Në të njëjtën seancë dëgjimore në Këshilli, avokati i subjektit të hetimit Naser Peci deklaroi se qëndron pran të gjitha deklarimeve që i ka prezantuar të panelit hetimor dhe e mbështet në tersi raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura të panelit hetimor duke kërkuar nga Këshilli që gjyqtari Ylber Shurdhiqi të lirohet nga përgjegjësia disiplinore.

Për të vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore, Këshilli i administroi këto prova: Vendimi KGJK Nr.115/2022/10.03.2022, për themelimin e komisionit hetimor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 10.03.2022; Vendimi KGJK.nr.115/2022 10.03.2022 për suspendimin e subjektit hetimor Ylber Shurdhiqit nga pozita e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit; Kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor Ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës së Apelit kërkesë dërguar më 09.03.2022; Aktin përcjellës GJA.nr.218/2022 për transferimi e ankesës nga Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë 03.07.2022, dërguar Ushtrues i detyrës së Kryetarit të Gjykatës së Apelit; Dokumentin shoqërues nga Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë, dërguar më 23.02.2022 kryesuesit të KGJK-së, Njoftimin e Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore në SKGJK, datë 23.02.2022, i është dërguar ankuesit Provat e ankuesit Ankesën e ankuesit e datës 21.02.2022: Aktin përcjellës nga Kryesuesi i KGJK-së i datës 10.03.2022 dërguar Prokurorit të Shtetit të Kosovës; Vërtetimin epranimit të vendimit Prokuror i Shtetit, pranuar 10.03.2022; Emailin për njoftim i datës 14.03.2022 dërguar nga gjyqtar, Gjykata Themelore në Prishtinë; Shkresa PPN.nr.77/2022 datë 14.03.2022 duke i dorëzuar kërkesën organit kompetent Kryeprokuror, prokuror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë për Kryeprokuror, Prokurorinë Themelore në Prishtinë; Njoftimin anëtarëve të panelit hetimor për hapjen e procedurës disiplinore AD/KGJK/06/2022, të pranuar inspektore gjyqësore me datë 11.03.2022 për Alush Sinani, Kryesues dhe anëtarët Hajrullah Aruqi dhe Avni Sylja; Konfirmimin për pranimin e njoftimit Ylber Shurdhiqi, subjekt i hetimit i pranuar 15.03.2022; Ankesën e avokatit Naser Peci (avokat i subjektit të hetimit) dërguar 24.03.2022 në Gjykatën Supreme të Kosovës; KGJK/114/2022. Përgjigje në ankesën e Kryesuesi i KGJK-së dërguar 31.03.2022; Procesverbalin e mbledhjes së parë të mbajtur me datën 31 mars 2022; Shkresa AA.nr.3/2022 Njoftim/kërkesë për përgjigje Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës dërguar 24.03.2022; Kërkesën drejtuar kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë më 31.04.2022 nga Alush Sinani, kryesues i panelit hetimor të datës 01.04.2022; Përgjigje e Kryeprokurorit Kryeprokurorit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, dërguar më 04.04.2022; Ftesën e subjektit të hetimit Ylber Shurdhiqi nga Kryesuesi i panelit hetimor Alush Sinani, dërguar më datë 08.04.2022; Konfirmimin e ftesës së subjektit hetimor Ylber Shurdhiqi me datë 14.04.2022; CD-ën dhe transkriptin e seancës së mbajtur më datën 21.04.2022; Autorizimin në cilësinë e mbrojtësit e avokatit Naser Peci nga Prishtina për ti ndërmarr të gjitha veprimet procedurale të datës 21 mars 2022; Procesverbalin e marrjes në pyetje për të dëmtuarin i datës 15.03.2022; Njoftimin me kërkesën e Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë të datës 26.04.2022. dhe 28.04.2022; Kërkesën nga Kryesuesi i Panelit Hetimor Alush Sinani për Prokuror, Zyra e Prokurorisë Speciale me datën 29.04.2022; Njoftim i datës 06.05.2022, nga Administratore e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit; Vendimin për ndërprerje të procedurës disiplinore me datën 06.05.2022; Përmirësimin e vendimit të datës 06.05.2022, në të cilën janë bërë lëshime teknike, i datës 06.06.2022; Procesverbalin e mbajtur me datën 06.05.2022; Ankesën nga subjekti hetimor për ndërprerjen e procedurës disiplinore të datës 20.05.2022; Vendimin KGJK.nr.275/2022, i datës

31.05.2022 me te cilën refuzohet ankesa e subjektit të hetimit; Përgjigjen nga Zëvendës Kryesues KGJK për Alush Sinanin, kryesues i panelit hetimor të datës 01.06.2022; Kërkesën e Alush Sinanit, kryesues i panelit hetimor për Zyra e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës me datë 30.11.2022; Njoftimin nga prokuror special për Alush Sinanin, kryesues i panelit hetimor të datës 12.12.2022; Raportin për mbylljen e rastit në Prokurorinë Speciale të Kosovës PPN.nr.69/2022 të datës 26.12.2023; Vendimin për revokim të suspendimit të subjektit hetimor Ylber Shurdhiqi KGK.Nr.567/2023, të datës 27 dhjetor 2023; Procesverbalin nga seanca e punës e mbajtur më 11.01.2024; Ftesë për seancën dëgjimore me date 23.01.2024, Alush Sinani, kryesues i panelit hetimore dërguar më 15.01.2024 subjektit hetimor Ylber Shurdhiqi; Informata e datës 17.01.2024 nga lidhur me kërkesën se a ka pasur të shqiptuar sanksion disiplinor ndaj Gjyqtarit Ylber Shurdhiqi; Konfirmimin për pranimin e ftesës për seancë dëgjimore nga subjekti i hetimit Ylber Shurdhiqi 15.01.2024; Me datën 22.01.2024 Hajrullah Aruqi anëtar i panelit hetimor njofton se për arsye shëndetësore nuk mundet të marr pjesë në seancë dhe kërkon që seanca të shtyhet për një datë tjetër; Emailin e datës 23.01.2024 për dërgim të vendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme; Kërkesë e datës 23.01.2024 për administratorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë Emailin e datës 24.01.2024 me te cilin është dërguar padia të Kryesuesit të panelit hetimor Alush Sinani; Me datën 24.01.2024 emailin e dërguar nga Kryesuesi i panelit hetimor Alush Sinani për caktimin e seancës dëgjimore me datën 02.02.2024, subjektit hetimor Ylber Shurdhiqi dhe anëtarëve të panelit hetimor; Emaili për njoftimin që seanca nuk është incizuar për shkaqe teknike 05.02.2024; Ftesë për subjektin, Kryesuesin dhe anëtarët e panelit hetimor për seancën e dytë disiplinore data 09.02.2024; Transkriptin e seancës dëgjimore të datës 09.02.2024; Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese si dhe komplet dosja-kopja e lëndës civile C.nr.5912/2021.

Në fjalën përfundimtare, Kryesuesi i panelit hetimor deklaroi se si panel bazuar në faktet dhe provat e mbledhura nuk kanë arritur të vërtetojnë se subjekti i hetimit, me rastin e vendosjes lidhur me padinë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë të ankuesit me veprimet e veta të ketë bërë shkelje disiplinore. Paneli është ardhur në përfundim sidomos duke u bazuar edhe në raportin e Prokurorisë Speciale të datës 26.12.2023, i cili raport ka përfshirë hetime të gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse pasi që ka grumbulluar informata të nevojshme nga intervistimi i subjektit të hetimit Ylber Shurdhiqi, dhe zyrtarëve Po ashtu prokuroria kishte bërë përpjekje që ta intervistoj edhe ankuesin por nuk kishte arritur të siguroj prezencën e tij, ndërsa Departamenti i Hetimeve të Krimeve Ekonomike dhe të Korrupsionit, dhe rrjeti social facebook kanë ardh në përfundim se të gjitha komunikimet në profilet e Ylber Shurdhiqit, me zyrtaret dhe për të cilat ka pretenduar ankuesi janë të pa vërteta.

Avokati i subjektit të hetimit në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet në tërësi raportin e panelit hetimor dhe kërkoj nga Këshilli që subjekti i hetimit të lirohet nga përgjegjësia disiplinore.

Këshilli ka analizuar raportin PPN.nr.69/2022 për mbylljen e rastit nga prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar, i cili raport ka konstatuar se nuk ekziston dyshimi i bazuar se gjyqtari Ylber Shurdhiqi të ketë kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Po ashtu, Këshilli nga provat e vërtetuara gjatë seancës dëgjimore dhe deklaratat e palëve, ka marrë

parasysh edhe atë se i gjithë inicimi i procedurë disiplinore ndaj subjektit të hetimit ka qenë i bazuar në dyshimin për kryerje të veprës penale të korrupsionit, siç ka pretenduar autoritetit kompetent.

Me tutje, Këshilli ka analizuar edhe raportin e panelit hetimor, i cili panel nuk ka gjetur prova dhe fakte për shkelje disiplinore të konsumuar nga subjekti i hetimit, me ç'rast raporti është vlerësuar si i besueshëm, pasi në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar lidhore, ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe vlerësimin të fakteve, prandaj në seancën për këshillim dhe votim vendosi që gjyqtarin Ylber Shurdhiqi ta liroj nga përgjegjësia disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.68/2024, datë: 7 mars 2024

Albert ZOGAJ
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Valon Totaj, Kryetar në Gjykatën e Apelit;
- Ylber Shurdhiqi, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit.